

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI NDËRMJET MINISTRISË SË PUNËS DHE POLITIKAVE SOCIALE TË REPUBLIKËS ITALIANE DHE MINISTRISË SË PUNËS, CËSHJTJEVE SOCIALE DHE SHANSEVE TË BARABARTA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË LIDHJE ME ZBATIMIN E MARRËVESHJES PËR MIGRACIONIN E PUNËS, NËNSHKRUAR NË 2 DHJETOR 2008.

Ministria e Punës dhe e Politikave Sociale e Republikës Italiane dhe Ministria e Punës, Cështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta e Republikës së Shqipërisë, tashmë e tutje të referuara si "Palët kontraktuese";

Bazuar në Marrëveshjen e nënshkruar në Tiranë në 2 Dhjetor 2008, lidhur me normat dhe organizimin e flukseve të punëtorëve migrantë ndërmjet dy vendeve;

Të vendosura të zhvillojnë bashkëpunimin dypalësh nëpërmjet krijimit të kushteve për nxitjen e menaxhimit të bashkërenduar dhe efikas të flukseve migratore, duke përfshirë punonjësit sezonalë;

Me synim lehtësimin e procedurave të përzgjedhjes, rekrutimit dhe vendosjes së shtetasve shqiptarë në tregun italian të punës, në rast mungesash të krahut të punës;

Të vendosura të nxisin rrugët ligjore të migracionit nëpërmjet mekanizmave të punësimit sezonal, kurseve të trajnimit dhe programeve të stazhit me qëllim punësimit;

Bien dakort si vijon:

**KAPITULLI I
PARIMET E PËRGJITHSHME**

**Neni 1
(Autoritetet kompetente)**

Autoritetet kompetente për zbatimin e Memorandumit aktual të Mirëkuptimit janë:

Për palën italiane:

Ministria e Punës dhe Politikave Sociale e cila do të veprojë nëpërmjet:

- Italia Lavoro s.p.a. – agjenci vendore e Ministrisë së Punës dhe Politikave Sociale;
- Organeve të autorizuara italiane përgjegjëse për lidhjen e kërkesës dhe ofertës për punë, sic përkrahjet në Shtojcën A, referuar si "organet e autorizuara";
- Agjencive të çertifikuara italiane për trajnime.

Për palën shqiptare:

Ministria e Punës, Cështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Drejtoria e Politikave Migratore, Rikthimit dhe Riintegrimin, nëpërmjet:

- Shërbimit Kombëtar të Punësimit, nëpërmjet Drejtorive rajonale të Punësimit dhe Zyrave Vendore të Punës;
- Qendrave publike të trajnimit profesional
- Qendrave privatë të trajnimit profesional të autorizuar dhe të certifikuar nga Ministria e Punës, Cështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta
- Organizatave ndërkombëtare të cilat trajtojnë çështje të migracionit në Shqipëri, në bazë të projekteve të përbashkëta

Neni 2 (Zyra Vendore e Koordinimit)

Në mbështetje të aktiviteteve për lidhjen e kërkesës dhe ofertës për punë si dhe të aktiviteteve të bashkëpunimit në aspektin e formimit profesional midis dy palëve, dhe me qëllim lehtësimin e marrëdhënieve midis dy palëve, shërbimeve vendore të punësimit dhe autoriteteve përkatëse italiane, pala italiane angazhohet të ngrejë një Zyrë Vendore Koordinimi në Tiranë.

Zyra do të:

- Nxisë marrëdhëniet me institucionet dhe shërbimet vendore;
- Inkurajojë shkëmbimin e informacionit rreth gjendjes së tregjeve të punës në të dy vendet mes palëve kontraktuese;
- Veprojnë në bashkërendim me autoritetet vendore për zbatimin e aktiviteteve kërkimore dhe përzgjedhëse si dhe për rekrutimin e krahut shqiptar të punës të destinuar për tregun italian të punës;
- Mbështesë "organet e autorizuar" duke përditësuar listën e tyre dhe duke ja komunikuar rregullisht këtë autoriteteve shqiptare;
- Në mirëkuptim me autoritetet dhe qendrat vendore të trajnimit do të ofrojë lehtësi për zbatimin e programeve të formimit;
- Mbështesë agjencitë e certifikuar italiane të trajnimit për nxitjen dhe zbatimin e aktiviteteve trajnuese
- Nxisë zbatimin e aktiviteteve të reja në kuadër të migracionit

KAPITULLI II KËRKIMI DHE PËRZGJEDHJA E KRAHUT TË PUNËS

Neni 3 (Kërkimi i krahut të punës)

Ndërmarrjet italiane dhe organet e autorizuar të cilat dëshirojnë të përzgjedhin dhe të rekrutojnë shtetas shqiptarë për një periudhë të caktuar kohore apo për një periudhë të pacaktuar, duke përfshirë edhe afate sezonale, nevojitet të kontaktojnë Zyrën Vendore të Koordinimit duke ndjekur modalitetet e përcaktuara nga Palët Kontraktuese në këtë Memorandum dhe në cdo protokoll shtesë.

Neni 4
(Punonjësit kandidatë dhe listat e disponueshmërisë)

Në bazë të neneve 4 dhe 5 të Marrëveshjes, cdo shtetas shqiptar i cili dëshiron të punësohet në Itali, mund të përfshihet në lista të vecanta të disponueshmërisë të hartuara nga shërbimet shqiptare të punësimit.

Pala italiane, nëpërmjet Zyrës së saj Vendore të Koordinimit, merr përsipër të sigurojë mbështetjen e nevojshme teknike për përpunimin e listave të lartpërmendura.

Shërbimet shqiptare të punësimit do të shpërndajnë informacione rreth mundësive për punësim që ofron tregu italian i punës.

Listat do të hartohen duke ndjekur standartet e përcaktuara nga pala italiane, ne marrëveshje me Autoritetet kompetente shqiptare, nëpërmjet Zyrës së saj Vendore të Koordinimit dhe do të përfshijnë: profilin profesional, kualifikimet, kompetencat dhe eksperiencat profesionale të kandidatit, si dhe cdo informacion tjetër të vlefshëm për prezantimin e tij profesional.

Në çdo rast, listat nevojitet t'u përmbahen kritereve të përcaktuara nga pala italiane dhe të jenë në përputhje me legjislacionin italian në fuqi. Në përputhje me ligjin italian, Zyra Vendore e Koordinimit do t'i paraqesë këto lista herë pas here tek përfaqësia diplomatike në vend.

Nëpërmjet sistemit elektronik të para – përzgjedhjes për paraqitjen e kandidatëve në tregun italian të punës, Zyra Vendore e Koordinimit do t'i shpërndajë listat tek organet e autorizuara dhe ndërmarrjet italiane.

Neni 5
(Përzgjedhja e kandidatëve)

Përzgjedhja e kandidatëve mund të bëhet në Shqipëri, nëse është e nevojshme, ku ndërmarrjet dhe organet e autorizuara mund të takojnë personalisht punonjësit e përfshirë në listat e disponueshmërisë të cilat do të jenë shpërndarë paraprakisht nga Zyra Vendore e Koordinimit.

Secila palë merr përsipër të sigurohet se kandidatët plotësojnë kriteret e hyrjes dhe qëndrimit në Itali sipas ligjeve dhe rregullave në fuqi.

Kandidatët shqiptarë nuk do të kryejnë asnjë shpenzim gjatë procesit të kërkimit, përzgjedhjes dhe vendosjes në tregun italian të punës.

KAPITULLI III
TRAJNIMI GJUHËSOR DHE PROFESIONAL, STAZHET

Neni 6
(Kurset e trajnimit)

Palët kontraktuese, në përputhje me legjislacionet kombëtare në fuqi, do të inkurajojnë trajnimin gjuhësor dhe profesional të kandidatëve për punëtorë migrantë për të plotësuar kështu kërkesat e tregut të punës për profile të kualifikuara profesionale.

Trajnimi gjuhësor do të organizohet në Shqipëri nga qendra të njohura zyrtarisht nga shteti italian për të siguruar vlefshmërinë e kompetencave gjuhësore të kandidatëve sipas standarteve evropiane.

Organet e referuara në paragrafin e mëparshëm përfshijnë organe të autorizuar sipas nenit 1 të këtij Memorandumi.

Kurset e trajnimit gjuhësor dhe profesional të nisura jashtë mund të përfundohen në Itali.

Neni 7 (E drejta e preferencës)

Punëtorët shqiptarë të cilët kanë ndjekur kurse trajnimi në Shqipëri do jenë kandidatë preferencialë për hyrjen në Itali me qëllime punësimi në përputhje me ligjet përkatëse vendore në fuqi.

Kandidatës shqiptarë nuk do të kryejnë shpenzime për ndjekjen e kurseve trajnuese.

Përzgjedhja e punëtorëve dhe pjesëmarrja e tyre në kurset e trajnimit synojnë vendosjen e kandidatëve në tregun italian të punës.

Neni 8 (Stazhet)

Ndërmarrjet dhe organet e autorizuar italiane do të përzgjedhin kandidatët pasi të kenë shqyrtuar listat e disponueshmërisë.

Kandidatët do të vendosen në tregun italian të punës në përputhje me legjislacionin përkatës.

KAPITULLI IV NDIHMA PËR KOMUNITETIN REZIDENT DHE DËRGESAT NË PARA TË MIGRANTËVE

Neni 9 (Migracioni qarkullues)

Pala italiane njih rëndësinë e përmirësimit të sistemit të vendosjes në tregun e punës dhe të rrugëve të kthimit dhe do të mbështesë iniciativa të përbashkëta të migracionit qarkullues në dobi të shtetasve shqiptarë me qëndrim të rregullt. Pala italiane do të zbatojë programe të migracionit qarkullues në bashkëpunim me organet e autorizuar dhe agjencitë e certifikuar të trajnimit.

Në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi, pala italiane, e bindur për rëndësinë e punësimit sezonal për nxitjen e rrugëve të migracionit qarkullues dhe duke patur parasysh situatën e përshtatshme të tregut të punës, do të shqyrtojë pozitivisht vendosjen e Shqipërisë në listën e vendeve që përfitojnë nga kuotat e migracionit sezonal.

Neni 10 (Integrimi)

Palët kontraktuese njohin rëndësinë e komunitetit shqiptar për integrimin social të migrantëve të rinj si dhe për zbatimin e iniciativave të zhvillimit në vendin e origjinës. Për këtë arsye, Ministria e Punës dhe e Politikave Sociale e Republikës Italiane do të rrisë rolin e komunitetit shqiptar nëpërmjet përfshirjes së drejtpërdrejtë të shoqatave shqiptare.

Shqipëria merr përsipër të angazhojë dhe mbështesë shoqatat e lartpërmendura, edhe nëpërmjet fushatave sensibilizuese në drejtim të institucioneve shqiptare të ngarkuara me ruajtjen e kontakteve me qytetarët që jetojnë jashtë.

Neni 11
(Dërgesat në para)

Në kuadër të rregullave lokale shtetasve shqiptarë të cilët kanë hyrë dhe jetojnë në Itali për qëllime punësimi u lejonet të dërgojnë vlera monetare në vendlindje.

Pala italiane angazhohet të japë informacionin e duhur mbi sistemin kombëtar të dërgesave në para.

KAPITULLI V
DISPOZITAT E ZBATIMIT DHE PERMBYLLESE

Neni 12
(Konsulenca dypalëshe)

Palët kontraktuese do të konsultohen rregullisht për të:

- Monitoruar zbatimin e këtij Memorandumi dhe paraqitur propozime për mirëfunksionimin e tij;
- Vlerësuar rregullisht këtë Memorandum;
- Zgjidhur problemet praktike të cilat mund të pengojnë zbatimin e Memorandumit aktual;
- Rekomanduar ndryshime në Memorandumin aktual.

Neni 13
(Zgjidhja e mosmarrëveshjeve)

Palët kontraktuese do të zgjidhin mosmarrëveshjet të cilat mund të lindin si pasojë e interpretimit apo zbatimit të këtij Memorandumi nëpërmjet bisedimeve dhe nuk do i drejtohen një pale të tretë për zgjidhjen e tyre.

Në pritje të bisedimeve, palët do të vijnë të përmbushin detyrimet e tyre sipas pikave të këtij Memorandumi.

Neni 14
(Vizibiliteti)

Palët kontraktuese angazhohen të bëjnë të njohura pikat e Memorandumit aktual në territoret përkatëse kombëtare.

Neni 15
(Hyrje ne fuqi)

Ky Memorandum Mirëkuptimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit.

Memorandumi aktual do të kete vlefshmëri tre-vjecare nga data e nënshkrimit por mund të shfuqizohet nga secila palë pas një njoftimi paraprak tre mujor;



Nënshkruar në Rome datë 19/07/11, në dy kopje origjinale, në italisht, shqip dhe anglisht, të gjitha tekstet autentikisht të njëjta. Në rast mosmarrëveshje, referencë do të jetë teksti në gjuhën angleze.

**Për Ministrinë e Punës dhe
Politikave Sociale të Republikës
Italiane**

**Për Ministrinë e Punës, Cështjeve
Sociale dhe Shanseve të Barabarta
të Republikës së Shqipërisë**

**Ministri i Punës dhe të Politikave
Sociale**

**Ministri i Punës, Cështjeve Sociale
dhe Shanseve të Barabarta**



SHTOJCA A)

ORGANET PËRGJEGJËSE PËR PËRSHTATJEN E KËRKESËS DHE OFERTËS PËR KRAHUN E PUNËS NGA VENDE JO ANËTARE TË BE.

Përshtatja e kërkesë-ofertës për krahun e punës në Itali, e njohur edhe si ndërmjetësim për qëllime punësimi, mund të administrohet ekskluzivisht nga organe të autorizuara posaçërisht nga Ministria Italiane e Punës dhe e Politikave Sociale. Ndërmjetësimi për qëllime punësimi është një shërbim që u ofrohet si ndërmarrjeve të interesuara italiane ashtu edhe personave në kërkim të mundësive për punësim.

Ky shërbim përfshin:

- 1) Mbledhjen e CV;
- 2) Përzgjedhjen e punonjësve;
- 3) Nxitjen dhe administrimin e përshtatjes midis kërkesës dhe ofertës;
- 4) Planifikimin dhe zbatimin e aktiviteteve trajnuese për përmirësimin e aftësive dhe kompetencave profesionale të kandidatëve;

Organet e autorizuara nga Ministria italiane e Punës dhe e Politikave Sociale janë të listuara në një regjistër të posaçëm, pas verifikimit nëse plotësojnë kriteret subjektive të besueshmërisë, profesionalizmit, aftësisë, integritetit dhe ndershmërisë, si dhe kriteret financiare si posedimi i një kapitali minimal aksionar prej € 600,000.00.

Organet kryesore të ndërmjetësimit për qëllime punësimi janë Agjencitë Italiane të Punësimit të cilat, pas marrjes së autorizimit, angazhohen të përshtasin profilet e kandidatëve për krah pune me kërkesat profesionale të cilësuar nga ndërmarrjet italiane.

Organe të tjera të autorizuara për ndërmjetësim për qëllime punësimi janë shoqatat e punonjësve, shoqatat e sipërmarrësve dhe organizatat e tyre të përbashkëta.

Lista e organeve të lartpërmendura do të përditësohet dhe do u komunikohet rregullisht autoriteteve shqiptare.

Kjo shtojcë është pjesë përbërëse e Memorandumit.